

VENDIM
Nr. 28/2015

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE”, NË
PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET
LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 55, pika 1, 19, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet nënkomisioni “Për administratën publike”, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është administrata publike.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

1. Blendi Klosi	Kryetar	(PS)
2. Oerd Bylykbashi	Zëvendëskryetar	(PD)
3. Vexhi Muçmata	Anëtar	(PS)
4. Armando Subashi	Anëtar	(PS)
5. Gent Strazimiri	Anëtar	(PD)

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 5.2.2015